



Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, nenit 2 dhe 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01 Nr 569/1 i dt. 16.12.2010 dhe nenit 8 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve nr.18/30 e datës 07.05.2013, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2016, merr këtë

V E N D I M

- I. Me të cilin miratohen kërkesat e Klubeve Sportive, Organizatave joqeveritare rinore dhe Shoqërive artistike-muzikore, që veprojnë në komunën e Rahovecit, me qëllim të përkrahjes-subvencionimit të tyre u ndahen shumat si më poshtë:

Nr.	Emri i Klubit, OJQ-së	Shuma në Euro
1.	Klubi i Futbollit "Rahoveci" Rahovec	12.500,00
2.	Klubi i Futbollit "18 Korriku" Bellacërkë	2.000,00
3.	Klubi i Basketbollit "Rahoveci" Rahovec	3.500,00
4.	Klubi i Shahut "Rahoveci" Rahovec	1.000,00
5.	Klubi i Futbollit "Ratkoci" Ratkoc	2.000,00
6.	Shkolla e futbollit "Burimi" Apterushë	800,00
7.	Shkolla e futbollit "Rahovera" Rahovec	800,00
8.	Shkolla e futbollit "Dardanët" Hoçë e Vogël	400,00
9.	SH.K.A "Rahoveci" Rahovec	800,00
10.	SH.K.A "Anadrinia" Denjë	800,00
11.	SHL "Kosova", Rahovec	300,00
12.	SH.K.A "Bajram Curri", Krushë e Madhe	2.500,00
13.	Këshilli Rinor i Rahovecit, Rahovec	600,00
	Totali	28.000,00

- II. Klubet Sportive, Organizatat joqeveritare rinore dhe Shoqëritë artistike-muzikore, subvencionohen në bazë të nenit 8 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve me nr.18/30 e datës 07.05.2013, me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve të tyre sportive dhe artistike.
- III. Klubet Sportive, Organizatat joqeveritare rinore dhe Shoqëritë artistike-muzikore, obligohen që të raportojnë çdo 6 muaj te Kryetari i komunës me raport të detajuar për shpenzimin e këtyre mjeteve.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

- V. Ky Vendim hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe do të regjistrohet në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe do të publikohet në ueb faqen e komunës.

01 Nr. 563
Rahovec, 29.02.2016

Kuvendi i Komunës së Rahovecit



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani

 **REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot. 563 Më 29.02 2016
Br. prot. _____ Dt. _____
RAHOVEC - ORAHOVAC